

Buletin nga Organizata për Ruajtjen dhe Zhvillimin e Gjirokastrës- GCDO

Nr. 3, Janar - Shkurt 2008

1. Ndryçimi i galerisë së hyrjes në Kalanë e Gjirokastrës



Një specialist ndryçimi nga Mbretëria e Bashkuar, së bashku me një specialist të Institutit të Monumenteve të Kulturës në Tiranë po punojnë për dizajnin teknik të ndryçimit të galerisë madhështore në Kalanë e Gjirokastrës. Ndryçimi do të mundësohet përmes konsumit të ulët të energjisë së prodhuar nga panele diellore. Projekti parashikohet të përfundojë në kohën e duhur për sezonin e ri turistik në

Gjirokastrër - qytet i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Për herë të parë në Shqipëri një monument kulture do ndryçohet me energji diellore – kjo pritet të japë sinjalin e rëndësishëm se energjia diellore ka një të ardhme të hapur në vendin tonë. Projekti bashkëfinancohet nga GCDO dhe GEF.

2. Nxënësit e shkollave të mesme mbjellin pemë në kodrën e Kalasë

Në një shteg të parkut, i cili tashmë është riaktivizuar prej punës së të rinjve vullnetare ndërkombëtare verën e kaluar, nxënësit e shkollës së mesme “Asim Zeneli” mbollën më se 50 fidanë pemësh të ndryshme. Mori pjesë edhe Kryetari i Bashkisë Flamur Bime. Aksioni synon të nxisë përpjekjet për rehabilitimin e sipërfaqes së gjelbëruar rreth Kalasë. Projekti ishte një përpjekje e përbashkët e GCDO-së me Bashkinë e qytetit.



3. Trajnimi për hotelerinë



USAID/EDEM dhe Qendra për Informim Turistik e GCDO-së organizuan një trajnim për administratorët e hoteleve në qytetin e gurtë. Trajnimi synonte instalimin dhe përmirësimin e shërbimit të prenotimit të hoteleve përmes internetit, në një kohë kur pritet që numri i turistëve në Gjirokastrë të rritet më tej këtë vit.

4. Fletëpalosja informuese për Antigonenë

Fletëpalosja për vizitorët në Parkun Arkeologjik të Antigonesë, (e cila ndodhet pranë Gjirokastrës), doli nga shtypi në dy gjuhë shqip dhe anglisht. Punë e përbashkët e GCDO-së me Zyrën për Administrimin dhe Koordinimin e Parkut të Antigonesë, ajo jep një shikim interesant historik mbi këtë park dhe se si ai mund të vizitohet. Antigonea është një nga 8 parqet arkeologjike në Shqipëri dhe përbën një potencial të madh për zhvillimin e turizmit kulturor në rajonin e Gjirokastrës.



5. Zhvillimi i artizanatit dhe Panairi Kombëtar i Artizanatit



Planet për zhvillimin e një panairi të tillë në Gjirokastrë në vjeshtë të këtij viti po ecin mirë. Panairi, që planifikohet të sjellë artizanë nga i gjithë vendi, fillimisht po koordinohet dhe bashkë-financohet nga GCDO, Bashkia e Gjirokastrës dhe shoqata "Miqësia", ndërkohë që po punohet për të tërhequr kontribues të tjerë. Gjithashtu, qendra kulturore shqiptare Art-Kontakt iu drejtua GCDO-së dhe Bashkisë së Gjirokastrës, me qëllim që të organizohet për herë të parë një event i artit modern në Kalanë e Gjirokastrës,

mundësisht në pikun e sezonit të ardhshëm turistik.

6. Xhamitë e humbura të Gjirokastrës



GCDO ka mbështetur kërkime me interes për historinë e Gjirokastrës nëpër analet e shkruara, foto dhe monumente. Me historinë e saj të gjatë Gjirokastra paraqet dhjetëra episode, disa nga të cilat po dalin në dritë nga puna që po bën GCDO. Njëra nga to është historia e xhamive të zhdukura të Gjirokastrës; para vitit 1967 qyteti kishte 7 xhami të mëdha dhe teqe, ndërsa tani ka mbetur vetëm një xhami, ajo e Memi Pashës, ndërtuar në shek. XVIII. Një nga xhamitë e “zhdukura” ka qenë objekt i punës së GCDO-së në vitin 2004. Projekti ndërmori restaurimin e parkut të shtatë krojeve, në lagjen Meçite. Këtu është një kompleks i bukur mysliman i cili përfshin, veç xhamisë, edhe krojet që shërbenin

për të marrë abdes, si dhe hamamin. Në vijim mund të lexoni transkriptimin e mbishkrimit në njërën nga muret kryesore të kompleksit.

*U ndërtua bashkë me një pellg që të
ketë shumë përdorim*

*Që nga themeli për të sjellë sa më
shume lutje*

*Xhamia do të jetë e famshme, ashtu
qoftë dhe themeluesi i saj*

*Ai që ndërtoi pellgun do jetë i
lumtur*

*Nga gjithë besimtarët, këtij pellgu dhe
ndërtuesit të tij*

Meqë Muin Arslan¹⁾ është naib²⁾ dhe zot i fjalës

Për mua sot, nesër për ty (edhe) profetët që kanë ndërruar jetë

Me mirësi me sinqeritet të pastër, lutje e përshtatshme për të gjithë



7. Në vazhdimësi të 2008-ës GCDO do të përqendrohet në këto fusha:

- (i) Gjetjen e fondeve për muzeun “Kronikë në gur”, kushtuar qytetit dhe luginës së lumit Drino. Projekt propozimi, që përfshin një plan konservimi, kryerjen e dizajnit të muzeut me buxhetet përkatëse, do të përgatitet në muajt mars prill

¹ Ky duhet të ketë qenë emri i ndërtuesit

² Naib quhej në osmanishte zëvendës gjykatësi

- 2008 dhe menjëherë do nisin përpjekjet për gjetjen e fondeve. Ndërtimi do fillojë sapo të jenë siguruar financuesit.
- (ii) Përfundimi i instalimit të impiantit për ndriçimin me energji diellore të galerisë hyrëse në Kala dhe përmirësimit të eksperiencës turistike në të.
 - (iii) Krijimi në Gjirokastrë i një shkolle konservimi dhe restaurimi.
 - (iv) Zhvillimi i artizanatit në Rajon.
 - (v) Përmirësimit të eksperiencës së turistëve në qytetin UNESCO të Gjirokastrës.

Faleminderit !

**Për më shumë informacion rreth GCDO-së dhe përpjekjeve të saj në Gjirokastrë, lutemi drejtojeni drejtorit Sadi Petrela në spetrela@gjirokastra.org ose në cel 06920 78767.*